VENDIM
Nr. 57, datë 7.2.2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 199, DATË 10.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE, PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 2, të vendimit nr. 199, datë 10.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Znj. Elva Margariti, ministër i Kulturës, zëvendësohet me z. Blendi Gonxhja, ministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Znj. Delina Ibrahimaj, ministër i Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, zëvendësohet me z. Arbjan Mazniku, ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama